



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 252 Prot.

Tiranë, më datë 05.07 2024

VENDIM

Nr. 220, datë 05.07.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 05.07.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshim të pjesshëm të projektit “*Stabilizim emergjent i një pjese të murit verior në Kalanë e Lezhës*”, Monument Kulture Kategoria e së I-rë, Bashkia Lezhë, me aplikues Ad-Star shpk dhe zhvillues **Zyrat e UNOPS në Shqipëri**;
 2. Për sipërfaqen e propozuar për zbankimin e dheut në funksion të ndërhyrjes restauruese për murin verior në Kalanë e Lezhës, të realizohet gërmim arkeologjik dhe dokumentim i stratigrafisë arkeologjike nga IKTK;
 3. Rezultatet e gërmimit arkeologjik duhet të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
 4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

